



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BANKA E SHQIPËRISË

GUVERNATOR

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nr. _____, prot

Tiranë, më _____.____.2018

Nr. _____, prot

Tiranë, më _____.____.2018

MARRËVESHJE

PËR

**“BASHKËPUNIMIN PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE
MBIKËQYRJEN E SISTEMEVE TË SHLYERJES SË TITUJVE DHE
SHTËPIVE TË KLERIMIT TË TITUJVE”**

Palët:

Banka e Shqipërisë (si më poshtë “Banka”), me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht në marrëveshje nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.

dhe

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (si më poshtë “Autoriteti”), me adresë: Rruga “Dora D'Istria”, Nr. 10 , përfaqësuar ligjërisht në marrëveshje nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Koçi.

Duke qenë se në bazë të:

1. nenit 3, pika 4, shkronja “dh” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Banka ka përgjegjësinë të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave;
2. nenit 21, pika 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Banka është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë;
3. nenit 3 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për Sistemin e Pagesave”, i cili përcakton se Banka ka të drejtën që në përmbushjen të detyrave të saj, të përcaktuara në këtë ligj, të bashkëpunojë me cilindo autoritet vendas dhe/ose të huaj, me qëllim shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e veprimtarive, apo realizimin e marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, nëse gjykohet e nevojshme;
4. nenit 6, pika 3 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për Sistemin e Pagesave”, ku përcaktohet se në rastin e licencimit të sistemit të shlyerjes së titujve dhe të shtëpisë së klerimit të titujve, subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, fillon ushtrimin e veprimtarisë vetëm pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas kërkesave të legjislacionit të fushës;
5. nenit 8, pika 3 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për Sistemin e Pagesave”, ku përcaktohet se Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me marrëveshje dypalëshe, përcaktojnë rolin e secilit institucion, në lidhje me rregullimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e sistemit të shlyerjes së titujve dhe të shtëpisë së klerimit të titujve;
6. nenit 2, shkronja “a” të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Autoriteti është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të titujve dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investimet në tituj e që veprojnë në treg;
7. nenit 18/1, pika 1, të ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, sipas të cilit Autoriteti lidh marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të

huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar për të bashkëpunuar, shkëmbyer informacione, apo kryer inspektime të përbashkëta;

8. nenit 42, pika 7 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, ku përcaktohen përkatësisht veprimtaritë e klerimit dhe të shlyerjes si veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, dhe të cilat mund të ofrohen nga shoqëritë komisionere ose bankat në rolin e shoqërive komisioneve, të dyja të licencuara nga Autoriteti;
9. nenit 120 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, ku përcaktohet se transferimi i titujve të dematerializuar në bazë të një transaksioni të mbyllur në bursë ose në një treg të rregulluar, kryhet përmes kleringut dhe shlyerjes. Ku me klerim nënkuptohet krahasimi i informacionit mbi një transaksion ligjor të përfunduar, mbi titujt e dematerializuar, përcaktimi i afatit të pagesës dhe llogaritja e detyrimit për t’u paguar; dhe me shlyerje nënkuptohet procesi i ndërmjetësimit dhe mbikëqyrjes së pagesave dhe të transferimit të titullit, që lidhet me transaksionin ligjor;
10. nenit 123 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” ku përkufizohet regjistri i titujve, veprimtaria përkatëse dhe përcaktohet Autoriteti si autoritet licencues i tij;
11. nenit 138 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, ku përcaktohet se regjistri, përveç administrimit të të dhënave për titujt, nëse ofron shërbime të kleringut dhe shlyerjes, duhet të krijojë një fond garancie. Mjetet e fondit të garancisë krijohen nga pagesat e bëra nga shoqëritë, të cilat përdorin shërbimet e tij të kleringut dhe të shlyerjes.

Bien dakord të lidhin këtë marrëveshje (si më poshtë “Marrëveshja”) sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Baza juridike

Marrëveshja lidhet në bazë dhe për zbatim të akteve të mëposhtme:

- a) Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”; i ndryshuar;
- b) Ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për Sistemin e Pagesave”;
- c) Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“, i ndryshuar;
- d) Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt";

Neni 2 Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim të përcaktojë ndarjen e detyrave dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurave për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Përcaktimet e kësaj marrëveshje në lidhje me bashkëpunimin në kuadër të licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së sistemeve të operuara nga operatorë për shlyerjen dhe klerimin e titujve janë të detyrueshme për te dyja palët e marrëveshjes.
2. Regjistri-i Titujve është subjekt licencimi dhe mbikëqyrjeje nga Autoriteti. Në rastin kur Regjistri i Titujve kryen edhe funksione klerimi dhe shlyerjeje të titujve, nëpërmjet operimit nga ana e tij të një Sistemi për Shlyerjen e Titujve sipas përcaktimeve të Ligjit “Për Sistemin e Pagesave”, licencimi dhe mbikëqyrja e tij është objekt i kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Përfshirje nga fusha e zbatimit

Mbikëqyrja dhe rregullimi i sistemit AFISaR, i operuar nga Banka e Shqipërisë, për klerimin dhe shlyerjen e titujve të emetuara nga Shteti Shqiptar apo nga Banka e Shqipërisë është kompetencë e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5

Interpretime

1. Çdo kusht ose dispozitë e Marrëveshjes që mund të sjellë paqartësi interpretohet në frymën e ligjeve të cituara në nenin 1, si dhe në përputhje me qëllimin për të cilin palët lidhin këtë Marrëveshje.
2. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë Marrëveshje, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës.

Neni 6

Licencimi

1. Në përputhje me Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe aktet nënligjore, Banka shqyrton kërkesat e paraqitura pranë saj për licencim nga subjekte që synojnë të operojnë sisteme për shlyerjen e titujve dhe shtëpi të klerimit të titujve kur pozicionohen si blerës të çdo shitësi dhe shitës të çdo blerësi. Gjatë këtij procesi, Banka konsultohet me Autoritetin, për të vlerësuar qëndrimin e palëve në lidhje me përmbushjen e kriterëve nga ana e subjektit.
2. Banka, nga data e marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën për licensim të subjektit, i njofton subjektin vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse. Në rastin e vendimit për

dhënien e licensës, Banka njofton me shkrim subjektin dhe mbi detyrimin për t'u licencuar edhe nga Autoriteti përpara fillimit të veprimtarisë.

3. Në përfundim të procesit të tij të vlerësimit, Autoriteti njofton Bankën për vendimin e marrë në lidhje me subjektin e licencuar nga Banka.
4. Në përputhje me Ligjin për Titujt, Autoriteti shqyrton kërkesat e paraqitura pranë saj për licencim nga subjekte që synojnë të ofrojnë shërbimin e regjistrimit të titujve. Në rast se subjekti, i licencuar nga Autoriteti si regjistruar synon të kryejë edhe funksione klerimi dhe shlyerjeje të titujve nëpërmjet operimit nga ana e tij të një Sistemi për Shlyerjen e Titujve ose Shtëpie Klerimi për Titujt, Autoriteti i kërkon subjektit të licencohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë për operimin e Sistemit të Shlyerjes së Titujve ose si Shtëpi Klerimi për Titujt.
5. Në vijim ndiqen detyrimet për njoftime siç përcaktohet në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.
6. Për nevoja specifike gjatë fazës së licencimit që lidhen me: pjesëmarrësit në sistem, instrumentet e kleruara dhe të shlyera, me dobishmërinë e sistemit, si dhe çështje të tjera që synojnë qartësimin e procedurave licencuese, palët bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra – tjetrën për adresimin e tyre.
7. Subjekti i licencuar për operimin e Sistemit të Shlyerjes së Titujve ose si Shtëpi Klerimi për Titujt njofton me shkrim Bankën dhe Autoritetin për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është dhënë licenca. Çdo ndryshim miratohet fillimisht nga Banka dhe me tej nga Autoriteti.

Neni 7

Revokimi ose pezullimi i licensës

Në rastet kur njëra nga palët, bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës, mendon të pezullojë ose revokojë licencën e një operatori, ajo ka detyrimin të informojë menjëherë palën tjetër licencuese, dhe pas një procesi konsultues midis palëve, merret vendimi përfundimtar.

Neni 8

Lista e sistemeve

1. Banka publikon dhe përditëson listën e sistemeve dhe të operatorëve të tyre, duke përfshirë këtu edhe sistemet e shlyerjes së titujve dhe shtëpitë e klerimit të titujve.
2. Palët njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për revokimet dhe pezullimet e licencave, apo veprime të tjera që mund të çojnë në revokimin apo pezullimin e licencave, të subjekteve që bëjnë pjesë në listën e përcaktuar në pikën 1.

Neni 9

Rregullimi

1. Për rregullimin nëpërmjet akteve nënligjore të sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve, palët bazohen në parimet dhe standardet më të mira ndërkombëtare.
2. Palët bashkëpunojnë dhe konsultohen me njëra-tjetrën, si edhe me subjektet përkatëse, në fazën e hartimit të akteve nënligjore që trajtojnë çështje të licencimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve që rregullojnë.
3. Në kuadër të rregullimit palët mund të realizojnë analiza të përbashkëta të tregut, si dhe të shkëmbejnë opinione për materiale të kësaj natyre. Palët mund të organizojnë trajnime dhe të kërkojnë asistencë teknike të përbashkëta në kuadër të rregullimit.

Neni 10 **Mbikëqyrja**

1. Palët mbikëqyrin institucionet e licencuara bazuar në parimet ndërkombëtare të përcaktuara në Aneksin bashkëlidhur kësaj Marrëveshje. Në kuadër të procesit mbikëqyrës, Banka është përgjegjëse kryesisht për minimizimin e rrezikut sistematik në këto sisteme në kuadër të stabilitetit financiar, ndërkohë që Autoriteti është përgjegjës kryesisht për transparencën dhe mbrojtjen e investitorëve.
2. Palët ushtrojnë procesin mbikëqyrës ndaj operatorëve, nëpërmjet inspektimeve në vend ose mbikëqyrjes nga jashtë.
3. Në kuadër të koordinimit të veprimeve për mbikëqyrjen, palët në fillim të çdo viti bashkëpunojnë për krijimin e një plani të koordinuar për inspektime në terren (duke përfshirë edhe ato të përbashkëta), dhe njëherazi bashkëpunojnë për sasinë, cilësinë, formën e mbledhjes së të dhënave/informacionit nga subjektet e mbikëqyrura dhe mënyrën e përdorimit të tyre nga palët.
4. Gjithashtu, me qëllim koordinimin e veprimeve mes tyre, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse, palët do të organizojnë takime periodike ose të posaçme, në nivel teknik ose në nivelin e drejtuesve të lartë.
5. Për të mundësuar një proces efektiv mbikëqyrjeje palët:
 - a) në rastin e inspektimeve të subjekteve që mbikëqyrin, bashkëpunojnë për realizimin e raportit të inspektimit (në rastin e inspektimeve të përbashkëta) ose konsultohen mbi rezultatet dhe rekomandimet e inspektimeve që ka kryer njëra palë dhe që vlerëson se kanë rëndësi për palën tjetër;
 - b) konsultohen mbi sanksionet dhe/ose masat e tjera ndëshkimore në rastet kur konstatojnë shkelje ligjore dhe/ose nënligjore nga ana e subjekteve që mbikëqyrin.
6. Ndarja e detyrave dhe kërkesat për informacion gjatë procesit mbikëqyrës bëhet bazuar në Aneksin bashkëlidhur kësaj Marrëveshje, si dhe specifikimeve të përcaktuara në

aktet rregullative për sistemet e shlyerjes së titujve dhe shtëpitë e klerimit të titujve që duhet të miratojnë palët.

Neni 11

Konfidencialiteti dhe shkëmbimi i informacionit

1. Informacionet e shkëmbyera midis palëve, në bazë të kësaj marrëveshjeje, konsiderohen konfidenciale. Ato përdoren nga palët vetëm për qëllime të licencimit dhe mbikëqyrjes së sistemeve të shlyerjes së titujve, dhe shtëpive të klerimit të titujve, dhe nuk do i jepen palëve të treta pa pëlqimin e palës që ka gjeneruar informacionin, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj. Çdo ndarje e informacionit me palë të treta sipas legjislacionit përkatës, duhet t'i komunikohet palës që ka gjeneruar informacionin.
2. Në funksion të kësaj marrëveshjeje palët shkëmbejnë informacionin e nevojshëm në formë shkresore dhe/ose verbale, me përjashtim të rasteve kur Marrëveshja kërkon formën shkresore. Palët mbajnë rekorde të informacionit që kanë shkëmbyer mes tyre dhe të përmbajtjes së takimeve që kanë zhvilluar, dhe këto i nënshtrohen të njëjtave kërkesa për trajtimin e informacionit si në pikën 1.

Neni 12

Personat e kontaktit

1. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, palët informojnë me shkrim njëra-tjetrën mbi personat e kontaktit.
2. Palët njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën, për çdo ndryshim të personave të kontaktit.
3. Çdo ndryshim i mundshëm i adresave dhe i numrave telefonikë i njoftohet palës tjetër brenda 2 ditësh pune nga kryerja e këtyre ndryshimeve.

Neni 13

Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.
2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas përfundimit të orarit zyrtar të punës të secilës palë të Marrëveshjes, ai konsiderohet i marrë në orën 08.30 të ditës pasardhëse të punës.

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe i shtrin efektet për një kohë të pacaktuar.

**Neni 15
Ndryshimet**

Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim dhe me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve.

**Neni 16
Zgjidhja e Marrëveshjes**

Palët kanë të drejtë të zgjidhin këtë Marrëveshje duke njoftuar palën tjetër të paktën 60 ditë përpara datës që ato dëshirojnë ta zgjidhin.

**Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve nga zbatimi i Marrëveshjes, dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen në Gjykatën kompetente.

Marrëveshja, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur në 4 njësi në gjuhën shqipe, ku secila nga palët mban 2 njësi.

PËR

BANKËN E SHQIPËRISË

GUVERNATOR

Gent Sejko

PËR

**AUTORITETIN E MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ervin Koçi

ANEKS

Matrica e aplikueshmërisë së parimeve në tipologji të ndryshme të infrastrukturës së tregjeve financiare dhe institucioneve përgjegjëse.

<u>Parimi</u>	<u>SP*</u>	<u>RT*</u>	<u>SST*</u>	<u>SHKT*</u>	<u>Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e SST dhe KPQ</u>
<u>Autoriteti përgjegjës</u>	<u>BSH</u>	<u>AMF</u>	<u>BSH+AMF</u>	<u>BSH+AMF</u>	
<u>1. Baza ligjore</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH +AMF</u>
<u>2. Qeverisja</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+ AMF</u>
<u>3. Struktura për administrimin e plotë të rreziqeve</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>4. Rreziku i kreditit</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>5. Kolaterali</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+ AMF</u>
<u>6. Marzhi</u>				✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>7. Rreziku i likuiditetit</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+ AMF</u>
<u>8. Finaliteti i shlyerjes</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+ AMF</u>
<u>9. Shlyerja e parave</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+ AMF</u>
<u>10. Dërgesat fizike</u>		✓	✓	✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>11. Depozitar qendror i titujve</u>		✓			<u>AMF</u>
<u>12. Sistemet e shlyerjes për vlera të këmbëra</u>	✓		✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>13. Rregullat dhe procedurat për mos-shlyerjen nga ana e një pjesëmarrësi</u>	✓	✓	✓	✓	<u>AMF+ BSH</u>
<u>14. Ndarja dhe transferueshmëria</u>				✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>15. Rreziku i përgjithshëm i biznesit</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>16. Rreziku i kujdestarisë dhe investimit</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>17. Rreziku operacional</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+BSH</u>
<u>18. Pranimit dhe kërkesat për pjesëmarrje</u>	✓	✓	✓	✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>19. Marrëveshjet për pjesëmarrje disa nivelesh</u>	✓	✓	✓	✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>20. Ndërlidhjet e ITF-së</u>		✓	✓	✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>21. Efikasiteti dhe dobishmëria</u>	✓	✓	✓	✓	<u>AMF+BSH</u>
<u>22. Procedurat dhe standardet e komunikimit</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>23. Shpallja/ publikimi i rregullave dhe procedurave kyçe</u>	✓	✓	✓	✓	<u>BSH+AMF</u>
<u>24. Paraqitja e të dhënave të tregut</u>					

Burimi: CPSS-IOSCO – Principles for financial market infrastructures – Prill 2012

***SP**-Sistem Pagesash

RT- Regjistrari i Titujve

SST-Sistem i Shlyerjeve të Titujve

KT-Shtëpitë e Klerimit të Titujve